



► Deklaratë nga [EMRI i OAPB] për krizën e shkaktuar nga COVID-19 dhe mënyrën e reagimit ndaj saj si komb

► Data: Mars 2020

I. Hyrje

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) e ka shpallur COVID-19 pandemi, duke e çuar situatën e përhapjes së tij përtej një emergjence globale shëndetësore.

Kjo është një krizë shëndetësore, ekonomike dhe sociale që kërkon reagimin e të gjitha shtresave të shoqërisë sonë. Efektet e kësaj pandemie do të zgjasin. Vaksina ka mundësi të mos jetë gati edhe për të paktën 12 muaj. Gjatë 12-18 muajve të ardhshëm ka shumë gjasa që të kemi prurje periodike të kësaj krize. Tani është koha për veprim kolektiv dhe të menjëhershëm.

Aspektet ekonomike të krizës së shkaktuar nga COVID-19 janë të pashembullta. Për këtë arsye në këtë situatë do të nevojiten një sërë masash politike të ndryshme nga masat e përdorura në krizat e mëparshme. Në veçanti, ndikimi i COVID-19 në ekonomi do të jetë negativ pasi aktiviteti ekonomik po kufizohet nga masat e drejtpërdrejta të qeverisë dhe vendimet e biznesit për të mbyllur aktivitetin me qëllim kufizimin e përhapjes së virusit në shumë vende *përfshirë vendin tonë (OAPB-të duhet të hedhin informacionin përkatës bazuar në kontekstin e vendit të tyre).*

Rreziku i largimeve nga puna gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm po afrohet gjithnjë e më shumë. Shumë nga ata persona që do të humbasin të ardhurat e tyre do të jenë nga sektorët me paga më të ulëta të ekonomisë dhe të vetëpunësuarit. Ajo që nevojitet në këtë situatë është koordinimi i përpjekjeve të mëdha për t'i mbajtur punonjësit në punë, për t'i mbrojtur ata nga humbja e të ardhurave, për të lehtësuar humbjet financiare dhe për të përshpejtuar rikuperimin ekonomik.

Vendi duhet të demonstrojë përgjegjësi, solidaritet dhe efikasitet në përballjen me këtë emergjencë, duke mbrojtur të gjithë qytetarët e tij, punonjësit dhe ndërmarrjet e prekura nga kjo krizë. Të gjitha përpjekjet duhet të përqendrohen tek forcimi i rezistencës së punonjësve, ndërmarrjeve, aktiviteteve ekonomike dhe shërbimeve publike përballë kësaj krize si dhe tek forcimi i aftësisë për t'u kthyer në aktivitetet e tyre pas përfundimit të krizës.

II. Masat e politikave

[EMRI i OAPB-së] i kërkon qeverisë të krijojë një komitet të nivelit kombëtar, i përbërë nga përfaqësues të sektorit privat së bashku me aktorët e tjerë kryesorë si sindikatat, akademikët, shkencëtarët dhe grupet e komunitetit, si edhe ministrinë përkatëse për të adresuar pasojat ekonomike dhe sociale të pandemisë COVID-19. Përmes bashkëpunimit midis qeverisë, organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve për gjetjen e mënyrave për të zbutur ndikimin negativ të pandemisë, [EMRI i OAPB-së] beson se krizat ekonomike dhe sociale të krijuara nga COVID-19 mund të tejkalohen.

**** OAPB-të duhet të zgjedhin masat të cilat janë të përshtatshme për situatën e tyre nga lista më poshtë.**

Masat për të mbështetur sistemin shëndetësor:

- ▶ Shmangia e ndalimeve dhe kufizimeve të eksportit veçanërisht për eksportin/ importin e pajisjeve mjekësore dhe të ilaçeve.
- ▶ Ndërmarrjet mund të ndihmojnë anëtarët e stafit që kanë role mbështetëse në shërbimin shëndetësor (p.sh. duke ndihmuar si vullnetarë, role me kohë të pjesshme) me leje dhe modalitete të tjera për të mbështetur punën kritike të shërbimit shëndetësor.
- ▶ Marrja e masave të nevojshme për të siguruar që punonjësit e shërbimeve të domosdoshme, veçanërisht punonjësit në sektorin e shëndetësisë ose sektorë të tjerë të vijës së parë të mund të punojnë gjatë periudhës së kufizimeve të lëvizjes.
- ▶ Ndërmarrjet mund të mbështesin dhe forcojnë masat e shëndetit publik siç është rishikimi i masave paraprake të sigurisë për punonjësit që vazhdojnë të punojnë duke patur parasysh masat e distancimit social.

Masat për të mbështetur punonjësit:

- ▶ Bizneset duhet të garantojnë respektimin e udhëzimeve për masat e distancimit social për të ndihmuar në shmangien e tubimeve të panevojshme, ndërkohë që ruhet ofrimi i shërbimeve thelbësore dhe zinxhirët e furnizimit; [Emri i OAPB-së] do të sigurojë informacione në lidhje me procedurat e sigurisë për bizneset dhe punonjësit e tyre për t'i ndihmuar bizneset që të kuptojnë dhe menaxhojnë rreziqet e tyre. Ato përfshijnë masa të tilla si: zbatimi i procedurave të përmirësuara të pastrimit, siç është pastrimi më i shpeshtë i sipërfaqeve të forta në zonat e përbashkëta. Eliminimi i bufeve të vetë-shërbimit në mensë, shtimi i numrit të stacioneve higjienizuese të duarve dhe zvogëlimi i numrit të karrigeve në sallat e përbashkëta për të respektuar distancimin social.
- ▶ Qeveria duhet të sigurojë mbështetje adekuate në veçanti ndaj familjeve dhe punonjësve me përgjegjësi familjare gjatë

mbylljes së shkollave të fëmijëve të tyre, me qëllim zbutjen e vështirësive ekonomike të shkaktuara nga kriza.

- ▶ Qeveria duhet të sigurojë një dispozitë financiare në mënyrë që punëdhënësit të mund të përdorin ose të zgjasin lejet për arsye shëndetësore dhe mundësinë e përfitimit nga pagesa e papunësisë për punonjësit e tyre.
- ▶ Qeveria duhet të hulumtojë dhënien e granteve për nxitjen e menjëhershme të fluksit të parave dhe mbështetjen e pagesave të menjëhershme.
- ▶ Futja në përdorim e subvencioneve për paga shtesë dhe e masave të ndihmës sociale mund të sigurojnë të ardhura bazë për të gjithë punonjësit e prekur nga kriza. Kjo është një zgjidhje që duhet të studiohet nga qeveria.
- ▶ Fondet kombëtare siç janë fondet e sigurimeve shoqërore mund të aksesohen me norma me interes të ulët për të siguruar disa nga këto mbështetje. Përveç kësaj, mund të krijohen edhe fonde të veçanta kombëtare për 'COVID-19' që mundësojnë mbledhjen e kontributeve nga donatorët, filantropët, sektori privat dhe qytetarët për të mbështetur masat e mësipërme.

Masat për të mbështetur ndërmarrjet:

Tani qeveria duhet të marrë masa për të mbështetur bizneset e cënueshme dhe për të shmangur humbjen e vendeve të punës si dhe për të siguruar vazhdimin e operacioneve të bizneseve. Qeveria duhet të garantojë mbulimin me mbështetje financiare të ndërmarrjeve, veçanërisht të NVM-ve, dhe të të gjithë punonjësve, përfshirë këtu edhe të vetëpunësuarit.

Të gjithë këto hapa duhet të kenë për qëllim ruajtjen e infrastrukturës tonë ekonomike dhe mbajtjen e njerëzve dhe bizneseve në punë. Për ta bërë këtë, nevojitet vënia në dispozicion e burimeve të mjaftueshme dhe shpërndarja e informacioneve të qarta dhe të vazhdueshme në lidhje me mekanizmin/ mekanizmat për

rishpërndarjen e këtyre fondeve. Prandaj [EMRI I OAPB] sugjeron masat e mëposhtme:

- ▶ Qeveria duhet të zgjerojë më tej mbështetjen e saj për likuiditetin dhe masat e tolerancës përmes autoriteteve tatimore (dhe pushtetit vendor, kur është e nevojshme) dhe të vazhdojë të përshtasë mbështetjet të cilat mund të ndihmojnë në ruajtjen e sa më shumë ndërmarrjeve gjatë periudhës së krizës.
- ▶ Qeveria mund të ofrojë një program për kreditë me interes zero për ndërmarrjet me një madhësi të caktuar që janë prekur nga COVID-19 (matur nga industria dhe/ ose rënia e të ardhurave).
- ▶ Qeveria mund të ofrojë grante të drejtpërdrejta për ndërmarrjet për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të pagave ose humbjeve të të ardhurave.
- ▶ Autoritetet tatimore duhet të ofrojnë fleksibilitet për të ndihmuar kompanitë e prekura në lidhje me kufizimet e fluksit monetar.
- ▶ Për të çliruar paratë e gatshme për shlyerjen e taksave, duhet të merret parasysh një vonesë prej disa muajsh (që do të korrigjohet sipas evolucionit të situatës).
- ▶ Masat për të dhënë leje të përkohshme pa pagesë deri në rikuperimin nga COVID-19 duhet të merren parasysh për bizneset në vështirësi.
- ▶ Aty ku janë planifikuar diskutimet për negociatat mbi pagat minimale, ato duhet të shtyhen derisa të lehtësohet kriza.

Masat për të mbështetur sektorët e goditur rëndë:

Impakti i rënies së kërkesës dhe të ardhurave për bizneset e konsumit dhe të mikëpritjes do të ndikojë edhe në sektorët e tjerë gjatë javëve të ardhshme.

[EMRI I OAPB-së] do t'i mbështesë këta sektorë duke zhvilluar rrjete bashkëpunimi dhe forume për të hartuar zgjidhje sa më specifike për sektorin. Ne do të mbështesim në mënyrë specifike ndërveprimin midis ndërmarrjeve dhe

autoriteteve rregulluese në nivel sektor për të përvijuar kufizimet/ çështjet specifike sektoriale. Masat sektoriale stimuluese për firmat e prekura më rëndë mund të jenë të garantuara.

(OAPB-të duhet të vendosin informacionin përkatës sipas kontekstit sektorial)

Masat për të mbështetur zinxhirët e furnizimit:

Në këtë periudhë pasigurie, me ndërprerje të pashembullt, ndërmarrjet mund të hasin vështirësi për të siguruar lëndët e para kyçe, për të ofruar produkte dhe për të hyrë në tregjet kryesore. Mallrat thelbësore të tilla si mallrat ushqimore, duke përfshirë edhe bagëtitë, pajisjet dhe materialet jetësore mjekësore dhe mbrojtëse duhet të vazhdojnë të rrjedhin.

Problemet kryesore në lidhje me ndërprerjen e zinxhirit të furnizimit përfshijnë:

- ▶ Qasjen tek lëndët e para - kostoja dhe cilësia.
- ▶ Qasjen tek tregjet - produktet që prishen gjatë tranzitit për shkak të periudhave më të gjatë të dorëzimit.
- ▶ Ndërprerjet e kapitalit punues - koha më e gjatë për aktivizimin e tij.
- ▶ Humbjen e tregut - p.sh. tregjet e eksportit të kufizuara nga logjistika ose të zëvendësuara nga prodhimi.
- ▶ Rritjen e importeve për të adresuar rritjen e kërkesës (për grupe të caktuara produktesh).
- ▶ Buxhetet nënperformuese - ndikimi i periudhës joproduktive.
- ▶ Uljen e produktivitetit përgjatë zinxhirit të furnizimit - mirëqenia e punonjësve (fizike dhe psikologjike).

[EMRI I OAPB-së] nënvizon shqetësimin e saj për nevojën për të garantuar shmangien e ndërprerjes së furnizimeve me mallrat thelbësore për të luftuar COVID-19. Ne rekomandojmë masat e mëposhtme:

- ▶ Dhënia e ndihmesës për qeverinë për përpilimin e një liste kryesore të furnitorëve

dhe importuesve dhe mbledhjen e të dhënave kryesore për kapacitetin prodhues, aftësinë për ridimensionim, dhe kufizimet e tyre.

- ▶ Mbështetja për prodhimin e produkteve thelbësore mjekësore.
- ▶ Mbështetja financiare për financimin e tregtisë për të importuar produktet thelbësore mjekësore.
- ▶ Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve publike kryesore duke shmangur ndërprerjet në çdo aspekt (p.sh. energjia elektrike, uji).
- ▶ Puna me qeverinë për të garantuar që masat urgjente të ndërmara nga ajo të mos shkaktojnë shpërndarjen e zinxhirëve të furnizimit me shërbime thelbësore (si ushqim, ilaçe).

Masat për të mbështetur rimëkëmbjen tani:

Qeveria duhet të komunikojë qëllimin e saj për të ofruar një stimul të rëndësishëm fiskal dhe monetar (në koordinim me partnerët dhe donatorët kombëtarë). Qeveria tani mund të ndihmojë në kapërcimin e panikut i cili po përshkon të gjithë elementët e ekonomisë dhe shoqërisë sonë. Sinjalizimi i synimit për të zbuluar masa të tjera stimuluese për të mbështetur rikuperimin e kërkesës në të ardhmen do të ndihmojë në ruajtjen e shumë bizneseve dhe vendeve të punës gjatë periudhës së krizës. Me qëllim rivënien në punë të ekonomisë sonë të dëmtuar, me shumë gjasa nevojitet përgatitja e një pakete të koordinuar stimuluese fiskale në shkallë ndërkombëtare. Ne i rekomandojmë qeverisë që:

- ▶ Të përgatisë masa stimuluese për rastet kur pllakos emergjenca shëndetësore.
- ▶ Të planifikojë një gamë masash stimuluese fiskale për të garantuar rikuperimin në formë V nga kriza (d.m.th. një rënie mjaft e thepisur e shëndetit të ekonomisë dhe një rikuperim mjaft i shpejtë).
- ▶ Të hartojë programe intensive për punësimin në investime publike për strehimin dhe infrastrukturën tjetër.

Masat për të mbështetur ekonominë informale:

Si çdo biznes tjetër, edhe bizneset e ekonomisë informale po përballen me një ulje të numrit të klientëve për shkak të pandemisë. Konsumatorët shmangin tregjet e mbushura me njerëz. Distancimi social midis punonjësve në tregjet informale është i vështirë për shkak të të numrit të madh të njerëzve. E njëjta situatë haset edhe në sektorët e tjerë informalë si në transportin publik, riparimin e automjeteve dhe punën me metale. Ruajtja e higjienës duke larë duart me ujë dhe me sapun në këta sektorë është shumë e vështirë.

Mungesa e masave për lehtësimin ekonomik të bizneseve të vogla informale do të ketë efekte negative në nivelin e jetësës së komuniteteve të varfra. Propozimet lidhur me përfitimet nga shteti, me lehtësimin e taksave, me linjat e reja të kredisë ose me grantet e ndërmarrjeve e kufizojnë mbështetjen vetëm tek ndërmarrjet formale dhe punonjësit formalë. Asnjë nga këto masa nuk do të zbatohet për ekonominë informale. Përgjigja e qeverisë që synon lehtësimin ekonomik duhet të marrë parasysh edhe ekonominë informale ku humbjet e vendeve të punës dhe të ardhurave ka të ngjarë të jenë të rënda, aq më tepër që nuk mbulohen nga asnjë formë e mbrojtjes sociale. Ne duhet të fuqizojmë sistemet tona ekzistuese të ndihmës sociale në mënyrë që t'u ofrohet ndihmë atyre që kanë nevojë më të madhe. Në këtë mënyrë, do të bëhet i mundur adresimi i drejtpërdrejtë i krizës së mundshme të varfërisë në rritje duke prodhuar një efekt kompensimi për ekonominë në përgjithësi.

[Emri i OAPB-së] beson se sigurimi i mbështetjes për ekonominë informale gjatë kësaj krize është jetik. Mbështetja për ekonominë informale ka rëndësi edhe për shkak të rolit të rëndësishëm që mund të luajë ajo në përpjekjen për kontrollin e epidemisë gjatë kësaj periudhe.

- ▶ Meqenëse shumë punonjës informalë janë në kontakt me një numër të madh njerëzish, ata duhet të pajisen me solucione

higjienizuese, maska dhe pajisje të tjera mbrojtëse për të mbrojtur veten dhe të tjerët.

- ▶ Në tregjet dhe grupimet e tjera informale të sektorit nevojitet instalimi i pikave të furnizimit me ujë.
- ▶ Sigurimi i ndihmës së synuar për personat në ekonominë informale (ose personat që nuk marrin asnjë formë tjetër të grantit social) duhet të merret në konsideratë. Një grant i veçantë mund të adresojë nevojat e më të prekura. Ky grant mund të shërbejë edhe si një stimulim ekonomik kompensues për ekonominë në tërësi. Ekzistojnë gjithashtu edhe mundësitë për një risi të konsiderueshme në hartimin e granteve të tilla, për të optimizuar multiplikatorët ekonomik në ekonominë lokale. Përdorimi i teknologjisë së zinxhirit bllok në platformat e telefonisë celulare mund të anashkalojë transaksionet e kushtueshme bankare dhe në të njëjtën kohë të garantojë një nivel të lartë sigurie. Përdorimi i parave nëpërmjet këtyre platformave përfshin aftësinë për të gjurmuar transaksionet celulare, duke siguruar edhe një gamë të gjerë të dhënave ekonomike hapësinore.

[EMRI I OAPB-së] mbështet krijimin e një fondi kombëtar të veçantë për COVID-19 për qytetarët e cënueshëm që bënë të mundur mbledhjen e kontributeve nga donatorët, filantropët, sektori privat dhe qytetarët për të mbështetur masat e mësipërme.

III. Çfarë po bën [emri i OAPB-së]

[EMRI I OAPB-së] do të kryejë një studim për vlerësimin e nevojave të anëtarëve të tij për të vlerësuar ndikimin e pandemisë tek ndërmarrjet dhe punonjësi e tyre. Ky informacion më pas mund të ndihmojë në kalibrimin e reagimit në rang kombëtar.

- ▶ Ne do të punojmë ngushtë me qeverinë, gjatë gjithë periudhës së krizës, për të shkëmbyer informacione të sakta në lidhje me zhvillimin e saj. Kjo është kritike për të

luftuar lajmet e rreme dhe panikun dhe për të qetësuar tensionet sociale.

- ▶ Ne do të punojmë me sektorin bankar dhe institucionet financiare për të eksploruar masa të tilla si kreditë e buta për NVM-të, ngrirjen e borxheve dhe mekanizma të tjerë për të mbështetur NVM-të.
- ▶ Ne propozojmë krijimin e një strukture për të menaxhuar problemin e kompensimit që vjen nga shkelja e kontratave të shkaktuara nga çështje të tilla si pamundësia për të kryer eksporte për shkak të mungesës së lëndëve të para.
- ▶ Në kontekstin e qirave tregtare, qiradhënësit duhet të tregojnë fleksibilitet dhe ne do të zhvillojmë një proces këshillimor për këtë qëllim.
- ▶ Ne do të krijojmë një strukturë konsultimi për të mundësuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin më të ngushtë midis sistemit shëndetësor publik dhe atij privat.
- ▶ Ne do të punojmë me anëtarët për të identifikuar fushat kryesore të shërbimeve publike që do të gjenden nën presion në muajt e ardhshëm dhe mënyrën se si mund të reagojnë aktorët privatë.

Për t'u përgatitur për javët dhe muajt e ardhshëm, ajo që është më e rëndësishme është hartimi i planeve sa më të konsoliduara për vazhdimësinë e biznesit (PVB). Ne do të punojmë me anëtarët në një kohë sa më të afërt për t'i mbështetur ata për zhvillimin e PVB-së.

IV. Si do të veprojmë

[EMRI I OAPB-së] është plotësisht funksional gjatë pandemisë dhe ne do të vazhdojmë të ofrojmë shërbimet tona. Përballë sfidave për këtë realitet të ri ndërsa përshtatemi në distancimin social, kufizimet e udhëtimit, punën nga shtëpia dhe takimet e riplanifikuara ose të anuluar, ne kemi zbatuar një strategji për vazhdimësinë e biznesit për kryerjen e rutinës sonë të përditshme që na lejon të mbrojmë punonjësit tanë dhe të respektojmë rolin që

luajmë të gjithë për parandalimin e përhapjes së virusit tek familjet, miqtë dhe komunitetet tona.

Në frontin e politikave: Pandemia COVID-19 ka implikime të konsiderueshme për çdo fushë të politikës në të cilën është e angazhuar [EMRI I OAPB-së]. Ne mbetemi të fokusuar për të përcaktuar mënyrën më të mirë për angazhimin me partnerët tanë në biznes, dhe me qeverinë për të dalë me zgjidhje biznesi. Ne do të ruajmë rrjedhën e informacionit dhe mbështetjes që janë shumë të rëndësishme për të mbrojtur interesat tuaja. Stafi ynë do të vazhdojë të monitorojë dhe raportojë në lidhje me çdo masë apo zhvillim të ri të rëndësishëm për komunitetin e biznesit.

Shërbimet tona të trajnimit: Ne kemi zbatuar protokollat e distancimit social në të gjitha modulet tona të trajnimit. Janë siguruar solucionet higjienizuese dhe pajisjet e tjera mbrojtëse. Ne besojmë se programet tona të trajnimit zhvillohen në një hapësirë të sigurtë. Gjithashtu, ne po shqyrtojmë - nëse kriza zgjat - se si mund të transferojmë disa nga trajnimet tona në një hapësirë virtuale dhe të zhvillojmë trajnime në internet.

Komunikimi: Ne do të përdorim buletin tonë javor (ose një mjet tjetër të rregullt komunikimi) për të qëndruar në kontakt në lidhje me punën që po bëjmë për të siguruar përfaqësimin e vazhdueshëm, proaktiv të interesave tuaja tek qeveria. Ne kemi përgatitur edhe një faqe interneti posaçërisht për situatën e COVID-19. Kjo hapësirë do të prezantojë edhe nismat e anëtarëve të [EMRI I OAPB-së]-]. Kjo faqe tani është aktive dhe do të përditësohet çdo ditë.

[EMRI I OAPB-së] beson se të gjitha masat duhet të vlerësohen rregullisht për të përcaktuar nëse janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Vendi ynë po përjeton një krizë të madhe me përmasa të jashtëzakonshme, e cila po ndikon tek ne të gjithë. Prandaj tani ne duhet të bëjmë maksimumin për të ruajtur strukturën ekonomike dhe ekuilibrin shoqëror të vendit tonë.